



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 84-Qershor- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>





Përmbajtja:

Zbulohet busti i heroinës Xhevë Krasniqi-Lladroci.....	3
Mbahet takim i parë i KO për kremtimin e 16 Qershorit	3
Mbahet takimi publik me qytetarët e komunës së Malishevës	4
KKSB vlerëson të qetë dhe stabile sigurinë në komunë.....	5
Institucionet përgjegjëse të marrin në dorë situatën epidemiologjike në Malishevë	6
Me shumicë votash miratohet rishikimi i buxhetit për vitin 2010	7
Përurohet ujësjellësi për Damanek, Bubël dhe Qupevë	7
Këshilli i Drejtorëve diskuton përgatitjet për 16 Qershor	8
KK mori vendim për ndarjen e çmimeve për 16 Qershor	9
Mbahet darka tradicionale me mësimdhënësit e Malishevës.....	9
Përfundoi turniri tradicional në futboll të vogël “Ibrahim Mazreku”	10
Kërkohe koordinim i masave për keqpërdoruesit e ujit	11
Kryetari Kilaj priti një delegacion të parlamentit francez	12
U shënua 16 Qershori Dita e Çlirimit dhe Dëshmorëve të Malishevës.....	13
Komunës dhe Hidroregjionit i dorëzohet ujësjellësi i Gurbardhit	17
Kryetari Kilaj priti në takim përshëndetës komandantin e BSHJ-së gjeneralin Hofmeyer	18
Komuna e përgatitur për fushatën e korrje shirjeve	19
“Vepro me seriozitet-parandalo ethet hemorragjike”.....	20
KPF rekomandoi për KK raportin e auditorit gjeneral.....	21
Nuk do të lejohen punimet pa leje.....	22
Mbahet testi i arritshmërisë në Malishevë	23

Zbulohet busti i heroinës Xhevë Krasniqi-Lladroci

Drenovc/Malishevë, 1 qershor



Me rastin e Ditës së Shkollës dhe datëlindjes së 55-të të heroinës së kombit, Xhevë Krasniqi-Lladroci, në Drenoc(1.06.1956), është bërë zbulimi i bustit të saj, me anë të një ceremonie. Zbulimin e bustit e bënë kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj; bashkëluftëtari i Xhevës, gjenerali Agim Çeku; vëllai i dëshmores, gjeneral Selim Krasniqi; babai i dëshmorit (bashkëshortit të Xheves)Fehmi Lladrovci, Tush Lladrovci; dhe drejtori i shkollës Beqir Krasniqi.

Në aktivitetin e mbajtur me këtë rast, kryetar i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, çmoi lart veprën e Xhevë Krasniqit-Lladrovci, përderisa fjalime rasti kanë mbajtur edhe drejtori i drejtorisë komunale për Arsim.z. Isuf Morina dhe drejtori i ShMU “Xhevë Krasniqi-Lladroci”, Beqir Krasniqi.

Në fjalën e tij në mes tjerash kryetari i komunës z. Kilaj tha: “sot, në Datëlindjen e Xhevës dhe në Ditën e shkollës suaj, ju nxënës dhe arsimtarë të kësaj shkolle si dhuratë keni bustin e dëshmores e cila simbolikisht do të jetë jo vetëm roje e dijes, por edhe motivuese e sukseseve tuaja”.

Mbahet takim i parë i KO për kremtimin e 16 Qershorit

Malishevë, 2 qershor

Në sallën e mbledhjeve të KK të Malishevës, nën udhëheqjen e kryetarit të komunës, z.Isni Kilaj, është mbajtur takimi i parë i Këshillit Organizativ për festimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës.



Këshilli Organizativ, është i formuar me vendim të Kuvendit Komunal, i përbërë nga përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta dhe përfaqësues të OJQ-ve tjera nga Malisheva, ndërsa do të udhëhiqet nga kryetari i komunës z.Isni Kilaj.

Në këtë takim, janë diskutuar çështjet teknike të organizimit për shënimin e kësaj dite, si dhe janë dhënë propozime për mënyrën e shënimit, vizitat në familjet e dëshmorëve, në varrezat e dëshmorëve dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet për shënimin e kësaj date.

Detajet lidhur me aktivitetet që do mbahen për shënimin e 16 Qershorit, do të bëhen publike në ditët në vazhdim.

Mbahet takimi publik me qytetarët e komunës së Malishevës

Malishevë, 3 qershor

Sot, në sallën e mbledhjeve të Asamblesë Komunale, kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka mbajtur takim publik me qytetarët, takim ky i rregullt, që mbahet dy herë brenda vitit i paraparë me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale, nr.03/L040, dhe i paraparë edhe me Statutin e Komunës së Malishevës, neni 14.



Në këtë takim, kryetari Kilaj, ka informuar qytetarët për punët e kryera nga ana e komunës, projektet e realizuara dhe ato në realizim e sipër, si dhe angazhimet dhe obligimet tjera të kryetarit dhe komunës, por edhe departamenteve të tjera në raport me qytetarët.

“Qendra e Kompetencës, Shtëpia e Kulturës, Palestra Sportive, pastaj shkollat në Senik, Banjë dhe Mleqan, ujësjellësi për fshatrat

Bubël, Damanek dhe Qupevë, që brenda pak ditësh do të përrurohen, fillimi ujësjellësit për Turjakë e Burim, rruga nga lagja Mirëdita deri në fshatin Burim, Kolektori i ujërave



të zeza, investimet në rrjetin elektrik, granti për qeverisje të mirë, i ndarë nga USAID-i, pastaj ai nga MPMS-ja, fusha të sportit, janë disa nga projektet dhe punët që kanë përfunduar apo janë në përfundim e sipër”, ka thënë mes tjerash kryetari i komunës së Malishevës z. Kilaj, para të pranishmëve.

Po ashtu Kilaj, ka njoftuar edhe për shumë punë dhe projekte tjera që janë në plan, përderisa njoftoi edhe për fondin për ndërtimin apo sigurimin e strehimit për 16 familje, të parapara për këtë vit, familje të cilat do të përcaktohen nga një komision i veçantë. Më pas, kryetari Kilaj, i ka dëgjuar dhe iu ka dhënë përgjigje pyetjeve të të pranishmëve, për çështjet e ngritura nga ana e tyre.

KKSB vlerëson të qetë dhe stabile sigurinë në komunë

Malishevë, 4 qershor

Këshilli Komunal për Sigurinë në Bashkësi (KKSB), në mbledhjen e mbajtur sot, ka vlerësuar se situata e sigurisë në territorin e komunës së Malishevës, vazhdon të mbetet e qetë dhe stabile dhe pa indikacione të ndonjë lloji të përkeqësimit, përderisa shqetësim vazhdon të mbetet situata epidemiologjike.

Mbledhja e sotme është udhëhequr nga zëvendëskryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku, i cili ka falënderuar organet e rendit për krijimin e kësaj situatë të mirë në territorin e komunës së Malishevës, në veçanti Policinë e Kosovës, por edhe vetë qytetarët.

Ejup Zulfaj, nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka njoftuar për aktivitete e kësaj drejtorie dhe për vazhdimin projektit për spërkatjen selektive, ndërsa projekti do të vazhdojë edhe më tutje, pas përkrahjes me mjete shtesë nga ana e qeverisë lokale nën udhëheqjen e kryetarit Isni Kilaj.

“Siguria është në nivel, situata është e qetë dhe stabile dhe pa indikacione për ndonjë prishje të kësaj situatë”, ka thënë Istref Bytyçi, zëvendës komandant i stacionit policor në Malishevë. Bytyçi ka njoftuar se ka rënie të dukshme të rasteve të aksidenteve, ndërsa pak më shqetësuese mbeten rastet e vjedhjeve.

Në këtë mbledhje, me kërkesë të KKSB-së, ka raportuar edhe drejtori për Shërbime Publike, Alban Kastrati, për çështjen e mbeturinave, si një dukuri shqetësuese sa i përket mbrojtjes së ambientin.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Institucionet përgjegjëse të marrin në dorë situatën epidemiologjike në Malishevë

Malishevë, 7 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse që të shpallin situatë epidemiologjike dhe të marrin situatën në dorë, si dhe kërkoj që Drejtoria e Shëndetësisë t'i drejtohet përsëri Qeverisë së Kosovës, që të mbështeten me një fond prej një milion euro, për vitin e ardhshëm dhe të angazhohen mijëra punëtor për spërkatje. Këtë kërkesë kryetari Kilaj e ka bërë në takimin e sotëm (të rregullt) të Këshillit të Drejtorëve, pas raportimit të drejtorit për shëndetësi, Skënder Hoti, për situatën aktuale epidemiologjike në komunë, dhe pas rastit të dytë të vdekjes nga ethet hemorragjike, të një 22 vjeçari nga Panorci.

Drejtori Hoti, ka bërë thirrje që qytetarët të kenë më shumë kujdes, në veçanti fëmijët, të mos konsumohen frutat e malit (rast konkretë, dredhëzat).

“Si komunë jemi duke bërë të pamundurën edhe jashtë obligimeve dhe përgjegjësiive tona, ndërsa kjo situatë është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), e cila është në heshtje të plotë gjatë këtij viti, pa as edhe një vizitë të vetme, për tu njohur nga afër me situatën në këtë komunë”, ka shprehur shqetësimin e tij, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në Malishevë, z. Skënder Hoti.

Në këtë mbledhje, edhe drejtori për Buxhet e Financa, z. Vesel Krasniqi, raportoi se është bërë rishikimi i buxhetit për gjysmën e dytë të këtij viti, ku është përfshi edhe Qendra e Kompetencës, ndërsa në mbledhjen e së martës, pritet të miratohet ky rishikim, nga këshilltarët e Asamblesë Komunale.

Po ashtu edhe drejtori për Arsim, z. Isuf Morina, ka njoftuar për mbajtjen e testit të maturës në Malishevë, sipas të cilit “çdo gjë ka shkuar mirë dhe pa asnjë problem. Testit i janë nënshtruar 697 maturantë, prej tyre 550 të rregullt, 131 maturant nga viti i kaluar dhe 16 të tjerë nga arsimi për të rritur”, ka bërë të ditur drejtori Morina.

Në fund të takimit kryetari i komunës z. Isni Kilaj, ka bërë të ditur se gjatë ditës së nesërme, do të bëhet inaugurimi i ujësjellësit për Damanek, Bubël dhe Qupevë, në ora 11:00.

Nga mbledhja e VI e kuvendit

Me shumicë votash miratohet rishikimi i buxhetit për vitin 2010

Malishevë, 8 qershor

Në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Komunave në Republikën e Kosovës, dhe me Statutin e Komunës së Malishevës, sot është mbajtur mbledhja e VI e radhës-urgjente, me të vetmen pikë për rend dite: rishikimin dhe miratimin e buxhetit për vitin 2010.

Lidhur me këtë pikë, fillimisht janë dhënë sqarime në lidhje me thirrjen urgjente, të kësaj mbledhje për shkak të kërkesës së bërë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, që do të thotë se afati ka qenë shumë i shkurtër, prandaj edhe është dashur të thirret një mbledhje e tillë.

Në këtë kontekst, kanë paraqitur vërejte këshilltarë si nga pozita, po ashtu edhe nga opozita, dhe është kërkuar që herëve tjera edhe ministria të ketë në konsideratë kohën dhe rëndësinë e kërkesave që i drejton nëpër komuna.

Në lidhje me disa ndryshime në buxhet, sqarime ka dhënë drejtori i Drejtorisë së Financave, z. Vesel Krasniqi, ndërsa më tej ka pas edhe pyetje, përgjigje dhe sqarime, si rezultat i të cilave ka pasuar miratimi i këtij rishikim-buxheti, me shumicë votash.

Mbledhja është kryesuar nga z. Ragip Begaj, kryesues i kuvendit.

Përurohet ujësjellësi për Damanek, Bubël dhe Qupevë

Malishevë, 8 qershor

Sot në fshatin Bubël, është bërë përrurimi i ujësjellësit për fshatrat Damanek, Bubël dhe Qupevë. Përrurimin e ujësjellësit e kanë bërë kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe drejtoresha e USAID-it, Patricia Rader.

Ndërtimi i këtij rrjeti të ujësjellësit, ka kushtuar 360 mijë euro, mjete këto të siguruar nga





Komuna e Malishevës, USAID-i dhe Hidroregjioni jugor, ndërsa do t'i furnizoj me ujë rreth 2700 banorët të këtyre fshatrave.

Me rastin e përrurimit, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka falënderuar të gjithë donatorët si dhe të gjithë banorët e këtyre fshatrave për bashkëpunimin e mirë në realizimin e këtij projekti jetik. “Falënderoj Qeverinë e SHBA-ve, për mbështetjen vëllazërore, që na ka dhënë në vazhdimësi dhe tani si mbështetësin e fuqishëm për ndërtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës”, ka thënë z. Kilaj, me rastin e përrurimit të këtij ujësjellësi. “Uroj që ky projekt të zgjidh përfundimisht problemin e ujit të pijes dhe të shuaj etjen e këtyre banorëve, që deri më sot, problem kryesor e kanë pasur sigurimin e ujit për pije”, ka vazhduar më tej kryetari, duke i uruar dhe duke i ftuar ata për një shfrytëzim sa më racional të ujin.

Në anën tjetër Patricia Rader, drejtoreshë e USAID-it, është shprehur të jetë e kënaqur për këtë investim. “Jam krenare që USID-i ka pasur mundësi të investoj në këtë projekt, pasi uji është diçka qenësore për jetë, por ju duhet ta ruani ujin dhe ta përdorni me kujdes”, ka thënë drejtoresha Rader.

Projekti i furnizimit me ujë për fshatrat Damanek, Bubël dhe Qupevë, konsiston me hapjen e pusit të thellë 85 metra, stacionin e pompave me kapacitet 15 litra për sekondë, gypin transmetues me gjatësi 2 mijë metra, rrjetin shpërndarës 17 km dhe rezervuarin e ujit me 300 metra kub ujë, dhe e gjitha kjo ka kushtuar 360 mijë euro.

Këshilli i Drejtorëve diskuton përgatitjet për 16 Qershor

Malishevë, 14 qershor

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, është diskutuar për përgatitjet përfundimtare në lidhje me organizimet për kremtimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Kryesisht janë diskutuar çështjet teknike rreth organizimit, ku kryetari Kilaj ka kërkuar angazhim dhe përkushtim maksimal nga ana e të gjithë sektorëve përgjegjës të komunës, në mënyrë që organizimi i kësaj dite të kalojë ashtu si është më së miri.

U diskutuan edhe çështje të tjera.

KK mori vendim për ndarjen e çmimeve për 16 Qershor

Malishevë, 14 qershor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, duke u bazuar në sajë, në mbledhjen e sotme, ka shqyrtuar dhe miratuar propozimet për ndarjen e çmimeve për trimëri e heroizëm, për kontribut në arsim dhe kontribut në shëndetësi, propozime të cilat i ka prezantuar para këshilltarëve komunal, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj.



Para këshilltarëve komunal, kryetari Kilaj, i ka prezantuar propozimet, të cilat paraprakisht i ka miratuar edhe Këshilli Organizativ për shënimin e Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, si dhe ka arsyetuar para këshilltarëve kontributin e të propozuarve në tri fushat.

Çmimin për trimëri e heroizëm “Imer Krasniqi”, do ta marrin Enver J. Hoti dhe Halil Berisha, për kontribut në arsim “Hamdi Berisha”, Ramiz Gegaj dhe Nikë Gashi dhe për kontributin e dhënë në shëndetësi “Shpëtim Robaj”, Enver Halitaj dhe Tafil Gashi.

Mbahet darka tradicionale me mësimdhënësit e Malishevës

Malishevë, 14 qershor

Edhe këtë vit, ka vazhduar tradita e darkës falënderuese për mësimdhënësit, në përfundim të vitit shkollor, ku kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe ministri i arsimit Enver Hoxhaj, i kanë falënderuar mësimdhënësit malishevas, për punën e tyre si dhe ju kanë premtuar rritje pagash gjatë këtij mandati të Qeverisë aktuale të Kosovës.



“Tradita po vazhdon dhe këtë traditë e ka krijuar kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi.

Është e sata herë që mblidhemi në këto darka të falënderimit, sepse janë një vit pune, një angazhimi i juaji që keni bërë, që ta përfundoni një vit shkollor, prandaj edhe kjo darkë shtrohet për nder tuajin, me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi. Ministri i arsimit, po bën reforma në arsim, reforma të cilat janë të dukshme dhe me të cilat po modernizohet jo vetëm sistemi i arsimit por edhe shoqëria”, ka thënë në fjalën e tij kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj.

Ndërsa ministri i MASHT-it, Enver Hoxhaj, duke i falënderuar mësimmshënësit, për punën e tyre në përfundimin e një viti shkollor, të suksesshëm, në emër të Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ju ka premtuar edhe një rritje të pagës, gjatë këtij mandati qeverisës.

“Kjo darkë dhe ky takim e ka një simbolikë dhe simbolika e kësaj është kjo: Ne si qeveri dhe unë si ministër, duam t’ju falënderojmë juve për çdo minutë, për çdo orë mësimi, për çdo ditë mësimi, javë mësimi dhe muaj mësimi që keni bërë gjatë vitit shkollor 2009-2010”, tha ministri Hoxhaj. Ndërsa në lidhje me ndërtimin e Qendrës së Kompetencës ministri Hoxhaj, tha se: “Qendra e Kompetencës, është njëra nga punët me të cilat unë mund të krenohem që kam bërë punë”, tha Hoxhaj. “Po bëjmë përpjekje maksimale për përmirësimin e pozitës së mësimmshënësit. Gjatë këtij mandati, do të keni edhe një rritje të pagave dhe ky është amaneti i kryeministrit, që po ju a sjellë unë”, ka premtuar ministri i MASHT-it, Enver Hoxhaj.

Përfundoi turniri tradicional në futboll të vogël “Ibrahim Mazreku”

Malishevë, 14 qershor

Në kuadër të organizimeve të shumta, për nder të 16 Qershorit Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, ka përfunduar me sukses edhe turniri tradicional në futboll të vogël, turnir i cili mban emrin e dëshmorit të kombit “Ibrahim Mazreku”.

Ekipi i “Menar Petroll”, nga komuna e Drenasit, edhe këtë vit është fitues i këtij turniri, duke e përsëritur suksesin e vitit të kaluar, pasi në finale,





kanë mundur ekipin “Toni e Mici” nga Rahoveci, me rezultat 5:4.

Finales së këtij turniri i ka paraprirë një ndeshje miqësore, mes Komunës së Malishevës dhe Komunës së Skenderajt, të prirë nga kryetarët e dy komunave, Isni Kilaj dhe Sami Lushtaku, përderisa në ekipin e Komunës së Skenderajt, ishte pjesëmarrës edhe djali Komandantit Legjendar Adem Jashari, Lulzim Jashari.

Mbahet takimi i organizuar nga Njësia e ujësjellësit

Kërkohet koordinim i masave për keqpërdoruesit e ujit

Malishevë, 15 qershor

Njësia operative e ujësjellësit në Malishevë, ka organizuar një takim në lidhje me temën “Situata e përkeqësuar e furnizimit me ujë, si dhe koordinimi i masave për stabilizimin e situatës”. Kjo ka ardhur si pasojë e motit të nxehtë që po mbretëron këtyre ditëve.

Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve komunale, në mesin e të cilëve edhe zëvendëskryetari i komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku.

Njazi Bytyçi shefi i Njesisë së Ujësjellësit të Malishevës, ua ka tërheqë vërejtjen shfrytëzuesve të ujit se mund të përballen me reduktime drastike dhe njëkohësisht i ftojë përgjegjës të institucioneve komunale në ndihmë për luftimin e keqpërdoruesve. “Të gjejmë forma të luftimit të kësaj dukurie”, ka kërkuar ai në këtë takim. Bytyçi i ka njoftuar përgjegjës të institucioneve që ishin të pranishëm në takimin e ftuar në zyre të tij, se njësia ka proceduar këtyre ditëve 10 raste të kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjellësit. Ka bërë me dije për 65 vërejtje drejtuar atyre që nuk i janë përgjigjur inkasimit dhe atyre që e keqpërdorin ujin. Ka paralajmëruar se të gjitha rastet që identifikohen do t’i përcjellë në gjykatë.

Në anën tjetër shefi i inspektorëve komunal të Malishevës, z. Ahmet Morina ka folur për masat e vartësve të tij në monitorimin e keqpërdoruesve të ujit. Sipas tij këtyre ditëve janë shqiptuar disa masa mandatare në këtë aspekt. “Jemi të gatshëm të ndihmojmë në të gjitha aspektet”, është shprehur ai.

Edhe Komandanti i Stacionit Policor të Malishevës, z. Bekim Begaj ka shfaqur gatishmërinë e plotë që policia të asistojë në rastet e domosdoshme, por ka kërkuar që thirrjet për asistencë të bëhen me kohë përveç në rastet urgjente. Financieri i Njesisë së Ujësjellësit, Sami Hoti ka folur për borxhe të mëdha që njësia i kanë shfrytëzuesit e ujësjellësit. Sipas tij borxhet e përgjithshme arrijnë shifrën prej rreth 165 mijë eurosh. Nënkyetari i Komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku ka vënë në dukje se furnizimi

i rregullt me ujë i banorëve është obligim, ndërkohë që ka përkujtuar edhe obligimet e qytetarëve për pagesën e ujit dhe kursimin e tij. A ka folur edhe për mundësinë e hapjes së burimeve alternative për rritjen e kapaciteteve të ujësjellësit.

Menaxheri Bytyçi ka njoftuar me këtë rast të pranishmit se njësia e tij ka përfituar një projekt prej 130 mijë eurosh për ndërrimin e pompave të ujësjellësit.

Kryetari Kilaj priti një delegacion të parlamentit francez

Malishevë, 16 qershor

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur një delegacion të lartë të parlamentit francez, të cilët po qëndrojnë në Kosovë, ndërsa në Malishevë, ishin të shoqëruar edhe nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Ramadan Avdiu.

Kryetari Kilaj, i ka informuar parlamentarët francez, për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, për Malishevën si territor, përderisa ka falënderuar ata për vizitën e tyre në Malishevë.



“”Ngritja e Qendrës Kulturore Franceze në Malishevë, do të na ofronte më shumë mes dy vendeve dhe në veçanti me kulturën franceze, si populli me kulturë më të ngritur në Evropë”, tha Kilaj, duke e vlerësuar lartë angazhimin e organizatës “Pelikan”, për ngritjen e Qendrës Kulturore të Francës, përderisa kërkoi që shteti francez ta mbështet realizimin e kësaj qendre.

“ Kemi konstatuar zhvillimet pozitive dhe personalisht kam kërkuar që në kuadër të vizitës në Kosovë, ta vizitojmë edhe Malishevën”, tha Christian Menard, deputet i Parlamentit të Francës, ndërsa projektin e Pelikanit, tha se është mundësi e mirë e bashkëpunimit mes dy shteteve.

Parlamentarët francez kanë uruar kryetarin Kilaj, me rastin e Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës.

U shënua 16 Qershori Dita e Çlirimit dhe Dëshmorëve të Malishevës

Malishevë, 16 qershor



Me aktivitete të shumta, është shënuar 16 Qershori, Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Malishevës. Përveç aktiviteteve kulturore dhe sportive që i kanë paraprirë kësaj date, janë bërë homazhe dhe nderime te varrezat e dëshmorëve dhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari.

Çmimi për trimëri dhe heroizëm "Imer Krasniqi",

iu është ndarë: Enver J. Hotit dhe Halil Berishës, ai për kontributin e dhënë shkollës shqipe "Hamdi Berisha", i është ndarë Ramiz Gegajt dhe Nikë Gashit, ndërsa për kontributin e dhënë në shëndetësi, çmimi ju është Enver Halitajt dhe Tafil Gashit.

“Në Malishevë dhe në fshatrat e kësaj treve, jeton një popullsi autoktone që është simbol i urtësisë, trimërisë, lavdisë, punës, përparimit, fisnik, i besës e burrërisë, me shpirt atdhetarizmi “, ka thënë Enver Hoti në fjalën e tij, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së.

Më pas Hoti, rolin e Malishevës në luftën për liri e ka vlerësuar si shumëdimensional dhe tepër të



rëndësishme e të veçantë, duke e ndarë në tri segmente, ndikimin e Malishevës si zonë e lirë, rolin e njësive “Çeliku” e “Lumi” , gjegjësisht brigadave 121 dhe 122 dhe shndërrimin e kësaj zone në qendër të pranimit të refugjatëve brenda vendit dhe qendër të sigurisë për strukturat udhëheqëse të luftës, si Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Qeveria e Përkohshme, Radio Kosova e Lirë dhe Kosova Press, si dhe një vend frekuentim i shumë misionëve ndërkombëtare, duke zënë vend të rëndësishëm në historinë e re të Kosovës.

“Kjo ditë e madhe për popullin tonë është po kështu një ngjarje e madhe që shënon ditën e triumfit të lirisë mbi robërinë dhe drejtësisë mbi padrejtësinë”, ka thënë Avni Robaj, kryetar i degës së AAK-së në Malishevë.

Fjalë rasti kanë mbajtur edhe Alban Kastrati në emër të AKR-së dhe Milazim Rudi në emër të LDD-së.



Në anën tjetër Habib Zogaj, në emër të OVL të UÇK-së në Malishevë tha se “Zoti kur deshi tua dhuroj lirinë shqiptarëve të Kosovës, bëri një krijesë që për emër i dha emrin ADEM, për ditëlindje i zgjodhi datën më të dashur për shqiptarët, 28 Nëntorin, kurse për vendlindje i zgjodhi më të shenjtin vend në Kosovë, djepin e trimërisë Prekazin”. Zogaj, jo të rastësishme, e cilësoi edhe ditën e rënies së dëshmorit të parë dhe të fundit të Malishevës, me 16 Qershor

1998 dhe 16 Qershor 1999, Imer Krasniqi (i pari), gjegjësisht Mentor Gashi (i fundit), dhe po ashtu 16 Qershorin 1999, si ditën e çlirimit. “Ne shoqatat e dala nga lufta konsiderojmë se populli dhe institucionet kanë dy detyra: të çmoi gjakun e dëshmorëve të kombit për çlirimin dhe të mos kursej djersën e tij për ndërtim”, tha në fund të fjalës së tij, Habib Zogaj, në emër të OVL të UÇK-së.

Më pas, shënimet e 16 Qershorit kanë vazhduar me aktivitete kulturore, me një koncert në mesditë në Sheshin e Dëshmorëve në Malishevë, për të vazhduar me një koncert tjetër, dedikuar të rinjve të kësaj komune, i cili ka përfunduar në orët e vona të natës.

Fjalimi i Kryetarit të Komunës, z. Isni Kilaj me rastin e 16 Qershorit

Të nderuara familje të dëshmorëve, veteran të luftës së UÇK-së, të nderuar mysafir, ju pjesëmarrës të këtij tubimi, Zonja dhe Zotrinjë,

Edhe sivjet, me rezultate të mëdha, po e kremtojmë Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve, dy festa këto të mëdha të cilat në Malishevë lidhen me datën e 16 qershorit. Kjo ditë e veçantë, na e kthen kujtesën në të kaluarën, që ta kujtojmë me respekt luftën e brezave që dhanë gjithçka për lirinë e Kosovës, na kthen tek kujtimi për luftën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës por le të na shërbej edhe si një ditë falënderimi dhe mirënjohje për aleatët tanë SHBA-të, NATO-n dhe gjithë popujt e botës së civilizuar të cilët ndihmuan fuqishëm luftën tonë për liri.

Dhe 11 vjet më parë, pikërisht në këtë ditë, UÇK-ja pas një lufte heroike, përfundimisht në Malishevë vendosi flamurin e fitores së saj përderisa po atë ditë, me 16 qershor 1999, në Kijevë gjatë luftimeve të përgjakshme bije i riu Mentor Gashi, dëshmori i fundit i rënë në fushën e betejës në këtë rajon, datë kjo e njëjtë me rënien e Imer Krasniqit, dëshmorit të parë të UÇK-së, i rënë me 16 qershor 1998.

Zonja dhe Zotrinjë,

Kësaj dite që ndanë në epoka historinë e Malishevës, i paraprinë ngjarje tjera të lavdishme, pasi gjenerata të tëra sakrifikuan, djersë, lot dhe gjak për të arritur deri te lufta e lavdishme e UÇK-së e cila finalizoj dhe përmbylli përpjekjet e Kosovës për LIRI dhe SHTET. Dhe në këtë luftë, Malisheva duhet të mburret për kontributin e saj pasi ishte ndër qendrat e para që është rreshtuar përkrah komandantit legjendar ADEM JASHARI kurse krahas dy Brigadave me mbi 2500 ushtarë të armatosur, Malisheva në këtë luftë i dha Kosovës 70 dëshmor dhe rreth 400 martir përderisa edhe tash, 11 vjet pas luftës, jemi në kërkim të mbi 40 qytetarëve tanë të rrëmbyer gjatë asaj kohe nga formacionet serbe.

Malisheva, gjatë kësaj periudhe ishte shndërruar në një qendër ushtarake dhe diplomatike pasi në këtë regjion vepronte SHP i UÇK-së prej nga bëheshin planet për luftën dhe çlirimin e vendit kurse në pjesën tjetër të Malishevës ishte vendosur KDOM-i amerikan që mund të quhet ambasada e parë amerikane në Kosovë. Në Malishevë pastaj vepronte Spitali Ushtarak, Reparti për prodhimin e autobлиндave, Reparti për prodhimin e uniformave ushtarake, Agjensia “Kosova – Pres”, Radio “Kosova e Lirë” e të tjera.

Përveç kësaj, Malisheva ishte shndërruar në një vend tmerri për forcat serbe pasi janë të njohura qindra beteja të vogla e të mëdha si në Malishevë, Dragobil, Drenoc, Bubavec, Lladrofc, Mirushë, Bellanicë, Carrallukë Tërpezë, Senik e ku jo tjetër në të cilat forcat serbe do të pësojnë humbje të mëdha.

Në këtë ditë të shënuar, ne përherë kujtojmë edhe dëshmorët Agim Elshani i rënë në Luginën e Preshevës sikur edhe Visarin, Labinotin e Hilmiun rënë në Mateç të Kumanovës në përpjekje për çlirimin e vëllezërve tanë në trojet tjera shqiptare.

Të nderuar vëllezër dhe motra,



Gjaku i derdhur për liri i bashkëluftëtarëve tanë, vuajtjet e mëdha dhe sakrificat e këtij populli për liri, gjithmonë janë porosi e qartë që ne të shkrijmë mundin dhe dijen tonë në krijimin e një jete më të mirë për qytetarin e Malishevës.

E dalë si gërmadhë nga lufta, Malisheva 11 vjet më vonë është një qytet me ndërtime të larta, me infrastrukturë moderne, me shkolla të reja, ujësjellës, rrugë dhe objekte tjera të infrastrukturës kurse projekte të rëndësishme janë kryer edhe në fshatra.

Kështu, vitin e kaluar, ne asfaltuam qindra kilometra rrugë duke lidhur me asfalt të gjitha fshatrat e Malishevës jo vetëm me qendrën komunale por edhe me komunat fqinje kurse projekte të ndryshme si shkolla, ambulanca, kanalizime, fusha sporti dhe projekte tjera janë kryer në shumë fshatra.

Sivjet, të dashur qytetar, do të filloj me punë Qendra e Kompetencës, një shkollë e re e ciklit të mesëm që është projekti më i shtrenjtë i ndërtuar ndonjëherë në Malishevë dhe e cila ka vlerën e një universiteti rajonal. Do të lëshojmë në përdorim po sivjet edhe Pallatin e Sporteve dhe Shtëpinë e Kulturës projekte madhore dhe shumë të rëndësishme për Malishevën. Krahës këtyre, kemi përfunduar sivjet shkollën e re në Tërpezë, kemi përfunduar shkollën e re dhe moderne në Mleçan kurse kemi në ndërtim e sipër shkolla tjera të reja në Banjë dhe Senik, po ndërtojmë kolektorin e ujërave të zeza, kemi përfunduar para pak ditësh ujësjellësin e ri për Bubël, Çypevë dhe Damanek, kemi përfunduar edhe ujësjellësin në Gurëbardh dhe do të fillojmë shtrirjen e tij edhe për fshatrat Burim dhe Turjakë, po bëjmë rrugë të reja si ajo për në Lagjen e Re dhe fshatin Burim si dhe projekte tjera.

Nga këtu, në këtë përvjetor, para jush qytetar të dashur të Malishevës ju siguroj se ne nuk do të ndalemi dhe zotohem se do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim për ngritjen e projekteve tjera të cilat do të lehtësojnë jetën tuaj pasi ju e meritoni të jetoni më mirë.

**Gëzuar Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve,
Lavdi të gjithë Dëshmorëve dhe të rënëve për LIRI...**

Komunës dhe Hidroregjionit i dorëzohet ujësjellësi i Gurbardhit

Malishevë, 22 qershor



Ujësjellësi i fshatit Gurbardh, sot i është dorëzuar për menaxhim Komunës dhe Hidroregjionit, pasi kanë përfunduar punimet e rrjetit primar të këtij ujësjellësi, pas një stërzgjatje të punimeve në ndërtimin e tij.

Me rastin e pranimit të çelësave të objekti të pompave të këtij ujësjellësi, zëvendëskryetari i

komunës, z.Rexhep Mazreku, i ka uruar banorët e Gurbardhit, për ujin, pasi përfundimisht do të zgjidhet problemi për ujë të pijshëm për ta.

“Ky ujësjellës, si dhe shumë projekte tjera, janë në vazhden e përpjekjeve të komunës për mirëqenie më të mirë për qytetarët e komunës së Malishevës”, ka thënë mes tjerash zv/kryetari Mazreku.

Ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Gurbardh, i cili ishte donacion i AER-it, në vlerë prej 170 mijë eurove, si dhe punimet që janë kryer nga firma “Getoari”, është dashur të përfundoj më 20 qershor 2007, por për shkak të zvarritjes së fillimit të punimeve dhe në ndërtimin e tij, vetëm tani kanë përfunduar punimet e rrjetit primar.

Pas marrjes së çelësave, do të bëhet edhe kyçja e shfrytëzuesve në rrjetin ujësjellësit, gjë e cila pritet të bëhet në javët në vazhdim.

Kryetari Kilaj priti në takim përshëndetës komandantin e BSHJ-së gjeneralin Hofmeyer

Malishevë, 23 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim komandantin e Brigadës Shumëkombëshe të Jugut (BSHJ), gjeneral brigade Manfred Hofmeyer. Qëllimi i takimit, kishte karakter përshëndetës për shkak të përfundimit të misionit në këtë detyrë, ndërsa i pranishëm ishte edhe gjenerali që do të marrë këtë detyrë, Stephan Thomas.



Z. Kilaj, duke falënderuar gjeneralin e KFOR-it, për kontributin e dhënë në përgjithësi në Kosovë, Regjion, e veçanërisht në komunën e Malishevës, është shprehur se ndjenë keqardhje për këtë ndarje. “Ndarjet nuk janë edhe aq të këndshme, mirëpo unë e kuptojë misionin tuaj me mandat. Si do qoftë ju jemi shumë mirënjohës dhe falënderues për kontributin tuaj që e keni dhënë gjatë këtij mandati. Uroj që të jeni mirë, kudo që të jeni”, kështu është shprehur ndër të tjera kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, përderisa për gjeneralin e ri në detyrë ka rikonfirmuar bashkëpunim, si dhe e ka njoftuar atë, se situata e sigurisë në këtë komunë, nga të gjitha qarqet kompetente, vlerësohet e qetë.

Edhe gjenerali i BSHJ-së, Hofmeyer, nga ana e tij e ka falënderuar kreun e komunës, për bashkëpunimin e treguar gjatë kësaj periudhe. “Unë ju falënderoj ju, për bashkëpunimin dhe kohën e ndarë për ne, dhe ju bëj me dije se nga këtu shkoj me përshtypje të mira, falë ndryshimeve pozitive që janë bërë në komunën tuaj”, është shprehur komandanti i BSHJ-së.

Më pas, kryetari i komunës së Malishevës, e ka bërë një paraqitje të profilit të komunës, për njoftim të gjeneralit të ri, duke u ndalur tek projektet që janë në realizim, si Qendra e Kompetencës (shkollë e mesme profesionale), që është në përfundim e sipër, Shtëpia e Kulturës, Palestra e Sportit, objekte shkollore në Mleqan, Bajë e Senik, fusha sporti për



shkolla, ndërtimi i kolektorit, përgjatë lumit “Mirusha”, përmes të cilit do të bëhet grumbullimi i ujërave të zeza, etj.

Gjatë këtij takimi është diskutuar edhe për situatën e etheve hemorragjike dhe për hapat që janë ndërmarrë deri tani.

Në shenjë respekti dhe falënderimi, në fund të takimit janë shkëmbyer dhurata modeste.

Komuna e përgatitur për fushatën e korrje shirjeve

Malishevë, 24 qershor

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural, ka përgatitur planin operativ për fillimin e fushatës së korrje shirjeve, si dhe ka formuar shtabin komunal.

Për këtë vit janë të mbjellë 3 143 hektar, prej të cilave 3 007 hektar me grurë, 33 hektar me tërshërë dhe 103 hektar me elb, ndërsa fushata e korrje shirjeve është e paraparë të filloj me 3 korrik.

“Është i formuar shtabi prej pesë anëtarëve, nga një përfaqësues nga Drejtoria për Bujqësi, ajo për Mbrojtje dhe Shpëtim, Shërbime Publike, pastaj inspektori sanitar dhe një përfaqësues nga kooperativa bujqësore “Malisheva”, ka njoftuar Milaim Morina, zyrtar për Bujqësi në drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Ky shtab ka për detyrë të përcjellë dhe ndihmoj në mbarëvajtjen e ecures së fushatës së korrje shirjeve dhe zbatimin e rregullores dhe kriterëve të saj në mënyrë që fushata të përfundoj me kohë dhe të jetë e suksesshme.

Sipas Morinës, në komunën e Malishevës, janë të regjistruara 25 autokombajna, ndërsa për realizimin e kësaj fushate, sipas planit, nevojiten edhe 15 autokombajna.

Çmimi për korrje shirje është 90 euro për hektar, pa lidhje të kashtës, ndërsa 100 euro me lidhje të kashtës, çmim ky që duhet të respektohet edhe nga autokombajnerët, përderisa çmimi, si dhe e tërë fushata e korrje shirjeve, do të mbikëqyret nga shtabi komunal i formuar për këtë qëllim.

Mbahet tryeza me temën

“Vepro me seriozitet-parandalo ethet hemorragjike”

Malishevë, 24 qershor



Sot, në sallën e mbledhjeve të kuvendit në Malishevë, është mbajtur një tryezë me temën “Vepro me seriozitet-parandalo ethet hemorragjike”. Kjo tryezë është organizuar nga Lëvizja Rajonale Mjedisore “Bells”, synimi i së cilës është që të jetë bartëse e proceseve mjedisore dhe e zhvillimit të qëndrueshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Krahas përfaqësuesve të institucioneve qendrore dhe lokale pjesëmarrës ishin edhe ekspertët e

IKSHP, ndërsa tryeza kishte për qëllim përcaktimin e hapave konkret për parandalimin e kësaj epidemie e cila ka përfshirë 50 për qind të territorit të Kosovës, por edhe (siç u tha) edhe Veriun e Shqipërisë.

Fjalën hyrëse të kësaj tryeze e ka bërë zëvendëskryetari i komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku, i cili pasi ka përshëndetur realizimin e kësaj tryeze shumë të rëndësishme, por edhe organizatorët e saj, ka paraqitur një kronologji aktiviteteve të organizuara nga qeveria komunale, përfshirë këtu edhe QKMF-në, në lidhje me këtë epidemi, që janë në interes të qytetarëve të komunës së Malishevës. “Unë ju falënderoj për këtë organizim që ka të bëjë me temën ‘vepro me seriozitet-parandalo ethet hemorragjike’, që neve si komunë tash e disa vite po na kushton me jetë njerëzish, dhe njëkohësisht ju njoftoj se ne si komunë, deri tash kemi ndërmarr një varg aktiviteteve në

lidhje me parandalimin e kësaj epidemie fatale”. Në këtë kontekst z. Mazreku, përmendi mbajtjen e ligjëratave për çdo vit, nëpër fshatra, shtypjen e fletëpalosjeve, posterëve dhe broshurave të ndryshme, me qëllim sensibilizimi të qytetarëve, përfshirë këtë ditë edhe spërkatja e zonave endemike.

Dr. Jusuf Dedushaj, nga IKSHIP në Prishtinë, në prezantimin e tij, Malishevën e ka quajtur epiqendër të kësaj epidemie, duke folur me këtë rast edhe për historikun e kësaj epidemie. Sipas tij “epidemia po merr karakterin kombëtar, prandaj ajo gjithsesi edhe duhet të luftohet me strategji kombëtare”, është shprehur Dedushaj duke bërë të ditur se realizimi i një projekti të tillë kushton jo më shumë se dy milion euro dhe siguron që deri në vitin 2015 të mos ketë të vdekur në territorin e Kosovës dhe të zhduket në tërësi kjo epidemi.

Në anën tjetër Dr. Salih Ahmetaj nga KI e QKU-së ka kërkuar implementimin e kësaj strategjie të hartuar nga ekspertët dhe është shprehur për që urgjentisht të kërkohet edhe ndihma e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), e cila do të duhej të ndihmojë në këtë drejtim. Edhe Dr. Ruzhdi Pllana, nga Ministria e Shëndetësisë, ethe hemorragjike i ka quajtur problem multi-disciplinar duke kërkuar me këtë rast angazhimin e të gjitha institucioneve të vendit në tejkalimin e gjendjes.

Skënder Hoti drejtor në DSHMS në Malishevë si dhe dr. Besim Zogaj nga QKMF “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë, kanë njoftuar për angazhimin e institucioneve komunale në përballimin e etheve hemorragjike, përderisa si përfundim i njëzëshëm i kësaj tryeze doli që institucionet e vendit ta përkrahin strategjinë për luftimin e etheve hemorragjike në shkallë kombëtare dhe për këtë qëllim të kërkojnë edhe ndihmën e OBSH në eliminimin e plotë të epidemisë.

KPF rekomandoi për KK raportin e auditorit gjeneral

Malishevë, 25 qershor

Komiteti për Politikë e Financa (KPF), në mbledhjen e sotme, ka rekomanduar për debat në Asamblenë Komunale, raportet e auditorit gjeneral për vitet 2008 dhe 2009.

Në këtë mbledhje të udhëhequr nga kryesuesi i Asamblesë Komunale, Ragip Begaj, janë shqyrtuar edhe disa kërkesa që ishin të drejtuara në KPF, e që kishin të bëjnë me Statutin e Komunës, pastaj me Rregulloren e Punës së KK-së, si dhe për çështje të përfundimit të vitit shkollor 2009-2010.

Këto të fundit, me shumicë votash të anëtarëve të KPF-së, nuk kanë kaluar për shqyrtim në Asamble, për shkak të mungesës së propozimeve konkrete në kërkesat e parashtruara, ndërsa raporti për përfundimin e vitit shkollor 2009-2010, nuk ka kaluar me arsyetimin se



ky vit akademik nuk ka përfunduar ende, pasi nuk ka përfunduar mbajtja e testeve të semimaturës.

Nga mbledhja e Këllit të Drejtorëve

Nuk do të lejohen punimet pa leje

Malishevë, 28 qershor

Këshilli i Drejtorëve, në mbledhjen e sotme të rregullt, të udhëhequr nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, kanë kërkuar nga inspektorati, shërbimet publike dhe urbanizmi, që në çdo mënyrë të ndërpriten dhe të mos lejohet asnjë punim pa leje paraprake, si të ndërtimeve, eksploatimeve në zonën e Goleshit apo shërbimi i udhëtimit me kombitaksi pa leje dhe pa linja udhëtimit.

Kryetari Kilaj, ka kërkuar nga këto shërbime që të mos lejojnë veprimet pa leje dhe respektim të ligjit, përderisa të njëjtën gjë e ka kërkuar edhe nga zyrtarët përgjegjës, që të veprojnë në bazë të ligjit dhe rregulloreve, dhe në të njëjtën kohë, nëse përgjegjësit nuk veprojnë atëherë do të ndëshkohen për mos parandalim të këtyre dukurive.

Po ashtu në këtë mbledhje, është kërkuar nga Drejtoria e Arsimit që të bëjë planifikimin për numrin e saktë të nxënësve dhe këtë planifikim ta dorëzojë në MASHTK, në mënyrë që në fillim të viti shkollor 2010-2011, të mos ketë probleme me numrin e përcaktuar të mësimdhënësve.

Sa i përket shëndetësisë, drejtori i këtij sektori, z. Skënder Hoti, ka njoftuar për përfundimin e suksesshëm të fazës së parë të spërkatjes selektive dhe vazhdimin e fazës së dytë, për eliminimin e rriqrave si masë parandaluese kundër etheve hemorragjike, ndërsa sipas raporteve, aktualisht në Klinikën Infektive, gjenden dy persona të infektuar me ethe hemorragjike, nga komuna jonë. Po ashtu, drejtori Hoti, ka njoftuar edhe për fillimin e shërbimit të mjekëve nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare, në territorin e komunës së Malishevës, ku varësisht nga këto qendra, mjeku do të qëndroj nga dy deri në katër ditë në javë, ndërsa në QMF-të e Kijevës dhe Bellanicës, do të vazhdohet me mjek të përhershëm.

Drejtori për Bujqësi, z.Sinan Kryeziu, ka njoftuar për përgatitjet e fushatës së korrje-shirjeve, për formimin e shtabit për përcjelljen e kësaj fushate, ndërsa në Ministrinë e Bujqësisë janë regjistruar 34 autokombajna, të cilat do të subvencionohen sipas rregullave të ministrisë.

Mbahet testi i arritshmërisë në Malishevë

Malishevë, 29 qershor

Në tri qendra arsimore, sot u mbajt Testi i Arritshmërisë, për 1370 nxënës të Komunës së Malishevës, të cilët kanë përfunduar klasën e nëntë, ndërsa mbajtja e testit ka filluar me kohë dhe çdo gjë ka shkuar në rregull.



Organizimi i mbajtjes së Testit të Arritshmërisë, është mbajtur në Gjimnazin “A.Frashëri”, SHMPEJ “L.Poradeci” dhe SHMU “I.Mazreku”, ndërsa për mbajtjen e testit në këto qendra janë prezent edhe komisionet, të cilat janë të përbëra nga një zyrtar i MASHTK, një zyrtar i Drejtorisë Komunale për Arsim dhe drejtori i shkollës, në të cilën mbahet testi.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Arsim, z.Isuf Morina, “procesi i fillimit të mbajtjes së testit, arritja e nxënësve dhe e vëzhguesve, ka qenë me kohë dhe nuk është shënuar asnjë problem, ndërsa Testit të Arritshmërisë, po i nënshtrohen 1370 nxënës”.

Edhe zyrtarët e MASHTK, e kanë vlerësuar në rregull procesin e mbajtjes së Testit të Arritshmërisë. “Testi ka filluar me kohë, administratorët po e kryejnë punën e tyre në mënyrën e duhur kurse nxënësve u kemi dhënë udhëzimet e duhura”, ka thënë Bashkim Shala, përfaqësues i MASHTK.